# DËSHMI ARKIVI

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

**A-445500**
VERSIONI

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Ngërçi politik në Kosovë, SHBA e pakënaqur: Po pengon axhendën e përbashkët |
| ADRESA | `https://www.gazetatema.net/rajoni/ngerci-politik-ne-kosove-shba-e-pakenaqur-po-pengon-axhenden-e-perbashket-i586211` |
| BURIMI | gazetatema.net |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 15 shtator 2026, 09:47:24 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 15 shtator 2026, 10:15:07 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `45bc304fa3fa3663c3dbc347d37b3a7ee7b4f6000ba5241bbae83f01e996bd13` |
| TEKSTI | `2e8dfd967694fad85486e1636dc406d65aead5b7712f940f4faba3b25bf6d8c1` |
| PAMJA | `545906974f5c160b32665ad2c3dd3af695e43ffaa6a34651594033d2d3599dc7` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `e92c60f385c1efb0b3283008757215482b2c5a28bc239ddb3393a15edabbe1f9` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | – |
| ANKORIMI | nuk është ankoruar ende<br>*Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/e92c60f385c1efb0b3283008757215482b2c5a28bc239ddb3393a15edabbe1f9`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

# Ngërçi politik në Kosovë, SHBA e pakënaqur: Po pengon axhendën e përbashkët

TemA
15 Shtator 2026, 12:15Rajoni TEMA



Shtetet e Bashkuara mbeten të përkushtuara ndaj pavarësisë dhe integritetit territorial të Kosovës, por e bënë të qartë se kriza e zgjatur politike dhe vonesat në formimin e institucioneve po pengojnë avancimin e axhendës  së përbashkët mes dy vendeve.

Zëvendësndihmëssekretari i Shtetit, Daniel Lawton pritet të dëshmojë përpara Kongresit, dhe atj të pohojë mes të tjerash se zgjedhjet e përsëritura dhe periudhat e gjata me qeveri në detyrë kanë penguar përparimin e prioriteteve të përbashkëta. Washingtoni i ka bërë thirrje Prishtinës që të përmbyllë formimin e institucioneve në përputhje me Kushtetutën dhe vendimet e gjykatave.

SHBA-ja shpreh shqetësim edhe për situatën e komunitetit serb në Kosovë, duke kërkuar të drejta dhe mbrojtje të barabartë për të gjithë qytetarët. Në të njëjtën kohë, thekson rëndësinë e KFOR-it për sigurinë dhe stabilitetin e vendit. Sipas Lawtonit, dialogu Kosovë-Serbi i ndërmjetësuar nga BE-ja ka ngecur për shkak të mungesës së vullnetit politik nga të dyja palët. SHBA-ja u bën thirrje Prishtinës dhe Beogradit të shmangin provokimet, të përmbushin zotimet dhe t'u rikthehen bisedimeve pa parakushte.

Ndërkohë, Uashingtoni po e forcon partneritetin me Serbinë përmes bashkëpunimit në energji, mbrojtje, siguri dhe ekonomi. Politika amerikane në Ballkanin Perëndimor mbështetet në tri prioritete: stabilitetin, interesat ekonomike dhe tregtare dhe luftimin e kërcënimeve të sigurisë. SHBA-ja kërkon që vendet e rajonit të fokusohen te zgjidhjet lokale, zhvillimi ekonomik dhe forcimi i kapaciteteve të mbrojtjes, ndërsa aleatët e NATO-s pritet të rrisin shpenzimet për sigurinë.

Për Shqipërinë, Bosnje e Hercegovinën, Maqedoninë e Veriut dhe Malin e Zi, Uashingtoni veçon bashkëpunimin në energji, mbrojtje, siguri dhe ekonomi. Mesazhi i përgjithshëm amerikan është se Ballkani duhet të fokusohet te stabiliteti dhe zhvillimi, ndërsa SHBA-ja do të vazhdojë angazhimin e saj në rajon përmes partneriteteve ekonomike dhe të sigurisë.

---

## Lini një Përgjigje

Koment *

Emër *

POSTOJE KOMENTIN

[Greqia i kërkon Parlamentit Europian heqjen e imunitetit të deputetit socialist të PASOK-ut, Nikos Papandreu]

21:30 Rajoni / 7 komente

[Vuçiç njofton dorëheqjen më 27 shtator, hyn në fushatë për zgjedhjet e parakohshme të 25 tetorit]

21:10 Rajoni / 3 komente

Lumir Abdixhiku: Bekim Sejdiu tregoi dinjitet

20:50 Rajoni / 5 komente

Gjyqi ndaj ish-krerëve të UÇK-së, Reuters: Kosova pret një vendim që mund të tronditë raportet me Perëndimin

20:25 Rajoni / 4 komente

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.